

Në Prishtinë, më 23 shkurt 2022
Nr. Ref.: 160/2

Në mbështetje të Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës Ligji Nr. 05/L-038, neni 14, dhe të Statutit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, nr. 446/2, të 11.05.2016, neni 17 dhe 30, Kuvendi i Akademisë, në mbledhjen e vet të mbajtur më 23 shkurt 2022, nxori këtë

**RREGULLORE
PËR VEPRIMTARINË BOTUESE
TË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS**

Neni 1

1. Rregullorja përcakton standarde t dhe kriteret për zhvillimin e veprimtarisë botuese të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Neni 2

1. Për veprimtarinë botuese të Akademisë është përgjegjës Këshilli botues, i cili përbëhet nga Sekretari shkencor, që është kryesues i tij, dhe nga sekretarët e sektioneve.

Neni 3

1. Veprimtaria botuese përfshin botimet e rregullta dhe të veçanta.
2. Botimet e rregullta përfshijnë veprat që botohen në kuadër të veprimtarisë së paraparë në programin e punës së sektioneve të Akademisë.
3. Botimet e veçanta përfshijnë monografitë, botimet enciklopedike, botimet e përvjetorëve, përbledhjet e kumtesave të konferencave, tryezave shkencore dhe të aktiviteteve të tjera shkencore e artistike.
4. Propozimet e botimeve të irregullta të Akademisë i paraqesin sektionet, i shqyrton Kryesia dhe i miraton Kuvendi.
5. Propozimet për botimet e veçanta iniciohen nga sektionet ose Këshilli botues dhe miratohen nga Kryesia. Përparësi kanë botimet e veçanta me interes kombëtar dhe ndërkombëtar.
6. Plani botues vjetor i Akademisë hartohet me dorëshkrime të dorëzuara deri në fund të muajit maj të vitit pararendës.

Neni 4

1. Akademia, sipas vlerësimit të sektioneve, boston vepra shkencore dhe artistike të anëtarëve të vet dhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm:
 - 1.1. Vepra studimore nga gjuhësia dhe letërsia, shkencat shoqërore, shkencat ekzakte dhe nga fusha e arteve;
 - 1.2. Vepra artistike nga letërsia, muzika dhe artet pamore;
 - 1.3. Monografi shkencore dhe artistike;
 - 1.4. Vepra enciklopedike;

- 1.5. Përbledhje të rezultateve të projekteve dhe hulumtimeve shkencore;
- 1.6. Përbledhje kumtesash nga aktivitetet shkencore e artistike; dhe
- 1.7. Revista, butetime, vjetarë dhe periodikë të veçantë;
2. Akademia realizon edhe botime që dalin nga bashkëpunimi shkencor dhe artistik me akademitë e tjera ose me institucionet shkencore e artistike brenda dhe jashtë vendit.

Neni 5

1. Akademia boton këto revista vjetore:
 - 1.1. STUDIME, revistë e Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë që boton studime shkencore, artikuj dhe kontributet të tjera nga fusha e gjuhësisë dhe e letërsisë;
 - 1.2. STUDIME SHOQËRORE, revistë e Seksionit të Shkencave Shoqërore që boton studime shkencore, artikuj dhe kontributet të tjera nga fusha të ndryshme të shkencave shoqërore;
 - 1.3. RESEARCH / KËRKIME, revistë e Seksionit të Shkencave të Natyrës që boton studime shkencore, rezultate të kërkimeve shkencore dhe kontributet të tjera nga fusha të ndryshme të shkencave të natyrës;
 - 1.4. VJETARI, që del një herë në vit dhe ku botohen të dhënat themelore, dokumentet me rëndësi dhe raportet për punën e Akademisë. Përgatitet nga sekretari i Akademisë; dhe
2. Me vendim të Kuvendit të Akademisë mund të themelohen edhe revista të tjera nga fushat e shkencave dhe të arteve.

Neni 6

1. Botimet e Akademisë publikohen në gjuhën shqipe ose në njëren prej gjuhëve botërore (anglisht, frëngjisht ose gjermanisht).
2. Botimet shqip të Akademisë duhet të kenë rezyme në njëren prej gjuhëve botërore (anglisht, frëngjisht ose gjermanisht), ndërsa botimet në gjuhët e tjera duhet ta kenë rezymenë në gjuhën shqipe.
3. Me vendim të veçantë të seksionit përkatës të Akademisë, trajtesat dhe artikujt në revista batojen edhe në gjuhë të huaja.
4. Studimet dhe artikujt e revistave shkencore duhen të kenë abstraktin në gjuhën e punimit, ndërsa rezymenë në njëren nga gjuhët botërore.
5. Nëse studimi ose artikulli është në gjuhë tjetër, rezymeja hartohet në gjuhën shqipe.
6. Veprat letrare, veprat muzikore, monografitë dhe katalogët e arteve pamore shoqërohen me parathënie për autorin dhe veprën.

Neni 7

1. Botimet e Akademisë realizohen në formate të standardizuara dhe në teknikat e aprovuara nga Këshilli botues.
2. Këshilli botues me propozimin e seksioneve përcakton standardet, teknikat, cilësinë e materialit të shtypit (letrën, lidhjen, etj.).
3. Këshilli botues standardizon formatet e botimeve të Akademisë.
4. Çdo botim i Akademisë duhet të ketë në faqet e fundit shënimet e katalogizimit të Bibliotekës Kombëtare, si dhe numrin ISBN.
5. Revistat e Akademisë duhen ta kenë ISSN.

6. Kryesia me propozimin e Këshillit botues miraton tirazhin e çdo botimi të Akademisë.

Neni 8

1. Botimet e Akademisë kanë, në kopertinë, në faqen e parë e të dytë, si dhe në pjesën e sipërme, emrin e Akademisë shqip dhe latinisht, e nën të emrin e seksionit, me numrin rendor të botimit.
2. Faqja e parë brenda kopertinave shënohet në gjuhën shqipe, ndërsa e dyta në njëren nga gjuhët e huaja.
3. Në faqet e para të brendshme të çdo botimi vihen emrat e recensemtëve, data dhe vendimi i seksionit përkatës apo i Kryesisë për lejimin e botimit.
4. Në faqen katër shënohet Copyright ASHAK, titulli i origjinalit dhe shënimë të tjera teknike.
5. Në botimet e materialeve të aktiviteteve shkencore në vend të recensemtëve shënohen emrat e anëtarëve të Këshillit organizues të aktivitetit përkatës.
6. Në faqen e fundit të botimit shënohen emrat e lektorit, dizajnerit, fotografit, notografit, shtypit dhe shërbimeve të tjera teknike.
7. Nëse botimi realizohet me ndihmën e donacioneve, në faqen 4 të botimit shënohet titulli i donatorit.

Neni 9

1. Dy ose më shumë seksione, në bazë të marrëveshjes, mund të propozojnë botime të përbashkëta.
2. Botimet e përbashkëta realizohen edhe me akademitë dhe institucionet e tjera. Në këto raste emri i akademisë ose institucionit tjetër shënohet krahas emrit të ASHAK-ut.
3. Redaktorin e botimeve të përbashkëta e cakton Kryesia.

Neni 10

1. Sekretarët e seksioneve, respektivisht udhëheqësit e këshillave dhe komisioneve të aktiviteteve shkencore janë redaktorë të botimeve përkatëse.
2. Redaktor i revistës *Vjetari* është sekretari shkencor.
3. Në raste të veçanta Kryesia cakton redaksitë për botime.

Neni 11

1. Revistarët e Akademisë kanë redaksinë, sekretarin e redaksisë dhe kryeredaktorin.
2. Redaksitë, sekretarët dhe kryeredaktorët e revistave propozohen dhe zgjidhen në seksionet përkatëse, me mandat tre vjeçar.
3. Redaksitë e revistave duhet të kenë edhe anëtarë jashtë Akademisë.

Neni 12

1. Dorëshkrimet i dorëzohen Akademisë të përgatitura sipas standardeve të Akademisë:
 - 1.1. Në versionin elektronik, në formatin MS WORD dhe PDF; dhe
 - 1.2. Në letër, 2 kopje.
2. Autori dorëzon dorëshkrimin të pajisur me shtojcat përkatëse (fotografitë, hartat, skicat, grafikët në rezolucionin e përshtatshëm, si dhe tabelat, treguesin e emrave në formatin e caktuar, etj.).

3. Krahas dorëshkrimit autorit dorëzon rezymenë në njëren prej gjuhëve botërore, si dhe abstraktet për artikujt shkencorë në revista.

Neni 13

1. Dorëshkrimet i paraqiten Akademisë, përmes administratës, në adresë të seksionit përkatës, bashkë me deklaratën e autorit se cilës kategori i takon punimi në fjalë (punim i pabotuar në përqindje, botim kritik, materiale arkivore, folklorike, leksikore) dhe se nuk është botuar ose është botuar pjesërisht.
2. Në deklaratën e autorit duhet të saktësohet përqindja e dorëshkrimit të pabotuar dhe në bazë të kësaj përqindjeje të caktohet honorari.
3. Për saktësinë e deklaratës përgjegjësinë e mbani autorit.
4. Sekretari i seksionit përkatës në mbledhjet e rregullta të seksionit paraqet dorëshkrimet e arritura, ku caktohen recensentët.
5. Dorëshkrimet e dorëzuara nuk kthehen.

Neni 14

1. Seksioni përkatës cakton së paku dy recensentë, ekspertë të fushës nga Akademia apo jashtë saj.
2. Për miratimin e dorëshkrimit për botim nevojitet vlerësimi pozitiv i dy recensentëve.

Neni 15

1. Vendimi për dorëshkrimin merret nga seksioni përkatës në bazë të vlerësimit të recensentëve.
2. Vendimet e seksionit janë:
 - 2.1. Dorëshkrimi miratohet për botim;
 - 2.2. Dorëshkrimi i kthehet autorit që të plotësohet sipas vërejtjeve të recensentëve; dhe
 - 2.3. Dorëshkrimi refuzohet.

Neni 16

1. Dorëshkrimet e kompletuara për botim sipas nenit 14 dhe nenit 15 nënparagrafi 2.1. i nënshtrohen lekturës, nëse seksioni nuk vendos ndryshe.
2. Caktimi i lektorëve bëhet me vendim të Kryesisë.
3. Për ndërrhyrjet në dorëshkrim autorit njoftohet nëpërmjet sekretarit të seksionit përkatës.

Neni 17

1. Dorëshkrimet e përgatitura për botim dorëzohen nga sekretarët e seksioneve te Sekretari shkencor i Akademisë, i cili i procedon te Shërbimi Profesional, Administrativ e Teknik i ASHAK-ut.
2. Dorëshkrimi dërgohet në shtyp pasi maketi të nënshkruhet nga autorit, sekretari i seksionit dhe sekretari shkencor.
3. Dorëshkrimet e aprovuara për botim, pjesë e programeve të punës të seksioneve, dërgohen në shtyp në kufijtë e afateve kohore që i cakton Kryesia.
4. Lejen për shtyp e nënshkruan Sekretari shkencor, kryesues i Këshillit botues.

Neni 18

1. Dorëshkrimi dorëzohet në shtyp pasi të lidhen kontratat sipas kushteve të parapara me këtë Rregullore.
2. Në kontratë, përveç të tjera, përfshihen këto elemente:
 - 2.1. Emri dhe adresa e kontraktuesve;
 - 2.2. Titulli i veprës që botohet;
 - 2.3. Vëllimi i veprës në tabakë autorit, respektivisht numri i faqeve;
 - 2.4. Regjistri i shtojcave;
 - 2.5. Shuma, mënyra dhe afatet e pagesës së honorarit të autorit;
 - 2.6. Tirazhi; dhe
 - 2.7. Numri i ekzemplarëve që i jepen autorit pa kompensim.
3. Kontratën, në emër të Akademisë, e nënshkruan sekretari shkencor i Akademisë.
4. Akademia nuk obligohet lidhur me afatin për shtypjen e dorëshkrimit.

Neni 19

1. Autori i dorëshkrimit të botuar nuk ka të drejtë të kërkojë ribotimin e dorëshkrimit tek një botues tjetër pa marrëveshje me ASHAK-un.
2. Akademia, në raste të veçanta, me vendim të Kryesisë lejon ribotimin e botimeve të saj, pasi të jetë shtetur tirazhi i plotë.
3. Në raste të veçanta Kryesia e Akademisë mund të lejojë përdorimin e materialeve të botuara sipas marrëveshjes me autorë apo shtëpi botuese.

Neni 20

1. Akademia nuk i boton dorëshkrimet që janë botuar në tërsi te një botues tjetër, përveç prezantimeve në projekte të veçanta.
2. Dorëshkrimet e reja merren në konsideratë për botim nëse së paku 75% e tekstit të dorëshkrimit është i pabotuar si libër autorial.
3. Akademia nuk përfshin në planin e vet botues tekstet shkollore dhe universitare.

Neni 21

1. Honorarët e autorit dhe honorarët e tjere rreth përgatitjes së botimeve të Akademisë përcaktohen me rregullore të veçantë.

Neni 22

1. Akademia i këmbej, i jep pa kompensim ose i shet botimet e veta.
2. Akademia botimet e veta i këmbej me akademitë e shkencave, institucionet shkencore, universitet, fakultetet dhe organizatat e tjera shkencore-kulturore brenda dhe jashtë vendit.
3. Këmbimi bëhet sipas parimit, të gjitha botimet e Akademisë me të gjitha botimet e institucioneve të tjera, libër me libër, pa marrë parasysh vlerën e tyre, ose libër me libër, sipas vlerës.
4. Këmbimet realizohen në bazë të marrëveshjeve paraprake të Kryesisë.

Neni 23

1. Akademia ua ndan pa kompensim nga një kopje të çdo botimi:
 - 1.1. Të gjithë anëtarëve të vet;
 - 1.2. Ministritë së Arsimit, të Shkencës, të Teknologjisë dhe të Inovacionit;
 - 1.3. Ministritë së Kulturës, të Rinisë dhe të Sporteve;
 - 1.4. Bibliotekës Universitare të Kosovës;
 - 1.5. Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë;
 - 1.6. Bibliotekës së Institutit Albanologjik të Prishtinës;
 - 1.7. Bibliotekës së Institutit të Historisë të Kosovës;
 - 1.8. Akademive me të cilat bashkëpunon ASHAK; dhe
 - 1.9. Bibliotekave përkatëse të fakulteteve të Universitetit të Prishtinës dhe bibliotekave të tjera të institucioneve publike të arsimit të lartë
 - 1.10. Bibliotekave rajonale të Kosovës
2. Bibliotekës Kombëtare Kosovës kopjet i ndahen sipas ligjit në fuqi.
3. Me kërkesën e institucioneve ose të individëve të interesuar, me pëlqimin e Kryesisë së Akademisë mund të jepen pa kompensim botimet e Akademisë.
4. Këtyre botimeve u vihet vula “Dhuratë” e ASHAK-ut.

Neni 24

1. Autorëve dhe bashkautorëve të botimeve u takojnë pa kompensim gjithsej 30 kopje.
2. Autorëve dhe bashkautorëve të punimeve të botimeve të përbashkëta (konferanca, tryeza dhe aktivitete të tjera shkencore) u takon nga një kopje pa kompensim.
3. Redaktorit, recensentëve, lektorëve, shërbimeve të dizajnit dhe shërbimeve të tjera teknike u takon nga një kopje e botimit.

Neni 25

1. Botimet e Akademisë shiten në librarinë e Akademisë dhe në forma të tjera.
2. Çmimet e shitjes i cakton Këshilli botues.
3. Librарive u lejohet marzha e rëndomtë ose e kontraktuar.
4. Botimet e Akademisë në raste të veçanta shiten edhe me ulje të çmimit deri në 50%.

Neni 26

1. Në arkivin e Akademisë ruhen së paku nga pesë kopje të çdo botimi.

Neni 27

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja mbí veprimitarinen botuese të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, nr. 266/2 e datës 21 mars 2017

Neni 28

1. Rregullorja hyn në fuqi 8 (tetë) ditë pas miratimit të saj nga Kuvendi i Akademisë.



Kryetari i Akademisë

Akademik Mehmet Kraja